

Nikola (Radovan) Jovanović

(18.06.1973, serb nga Lubovija, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Para fillimit të luftës, Rade ka qenë shef i ndërresës në stacionin policor në Shabac. E kishte gradën e rreshterit të klasës së parë. Nikola punonte në stacionin policor në Lubovi që nga viti 1993. E kishte gradën e tetarit të ri. Që të dy kanë qenë pjesëtarë të Njësiteve të Posaçme të Policisë në MPB-në e Serbisë. Në muajin korrik të vitit 1998, ata u dislokuan në fshatin Junik. Në pasditen e datës **24.05.1998**, Rade dhe Nikola ishin nisur me një veturë civile në Shërbimin e Punëve të Brendshme të Gjakovës/Đakovica, për të marrë racionet e ushqimit për pjesëtarët e njësitit të tyre. I kishin të veshura rrobat civile. Gjatë kthimit, në rrugën nga **Baballoqi/Babaloć** drejt Junikut/Junik, kanë rënë në pusi të organizuar nga pjesëtarët e UÇK-së. Që nga ajo ditë, është humbur çdo gjurmë lidhur me ta. Në muajin shtator të vitit 1998, policia e ka gjetur veturën e tyre në fshatin Strelc i Epërm/Gornji Streoc. Trupi i Rade Popadicić është zbuluar në **Liqenin e Radoniqit/Radonjičko jezero** më 15.09.1998. Mbetjet e tij mortore u varrosën në fshatin Piskotë/Piskot të Gjakovës/Đakovica. Rade u identifikua në bazë të analizës ADN, të cilën e bëri Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur në mars të vitit 2005. Në bazë të autopsisë, të cilën e kanë kryer patologët nga Beogradi, u konstatua se Rade u qëllua me një plumb në gjoks dhe një tjetër në pjesën e pasme të kokës. U varros në varrezat e qytetit Shabac më 25.03.2005. Fati i Nikolës nuk është ndriçuar deri më sot. Rasti i tij është evidentuar në listën e të zhdukurve, e cila administrohet nga KNKK-ja, nën numrin rendor YUK-050084-01.

Burimet: ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlcrdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdalReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\);](http://www.hlcrdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdalReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-);) *Otet na Kosovu*, Večernje Novosti, mars 2005, FDH-19931; *Dnevnik od 25. maja do 1. juna*, Ilustrovana politika, nr. 2055, FDH-16958; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 354, 361; FDH, *Fati i serbëve...*, 12, FDH-14277; *Ubijeni i zadavljeni*, Oteta istina

nr. 3, 6, 2005, FDH-19937; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; KNKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SMIP, *Teroristički...*, III, 973, IV, 263; Z. Stijović, *Kosmet...*, 108.

Ramiz (Sadik) Batusha

(24.08.1974, shqiptar nga Baballoqi/Babaloć, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor ndërtimor, pjesëtar i UÇK-së)

Pas mbarimit të shkollës së mesme, Ramizi punonte në sektorin e ndërtimtarisë. U inkuadrua në UÇK menjëherë pas themelimit të saj. Dy herë ka marr pjesë në bartjen e armatimeve nga Shqipëria drejt Kosovës. Ramizi u plagos gjatë betejës me forcat serbe në fshatin Baballoq/Babaloć, në fillim të muajit maj të vitit 1998. Pas disa ditësh pushimi, ai sërish u kthye në njësitin e vet. Në datën **25.05.1998**, Ramizi ka rënë gjatë luftimeve me forcat serbe në fshatin **Baballoq/Babaloć**.

Burimet: KMDLNIJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Adem (Zeqir) Ukëhaxhaj

(15.04.1964, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Ademi u rrit në **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg**. Pas akademisë së mbaruar ushtarake, e ka marr gradën e kapitenit të Armatës Popullore të Jugosllave (APJ). U largua nga APJ-a në vitin 1991 dhe u kthye në vendlindje. Pas fillimit të konfliktit në Kosovë, u emërua komandant i UÇK-së për Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg. Më vonë u bë komandant për tërë rajonin e *Vokshit/Vokša*, i cili e përfshin një numër fshatrash në komunën e Deçanit/Deçani. U plagos gjatë betejës me forcat serbe në Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg më **25.05.1998**. Bashkëluftëtarët e kanë çuar në spitalin e UÇK-së në fshatin Irz-niq/Rznić. Atje, më 2.06.1998, ndërroi jetë nga plagët vdekjeprurëse. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e Carrabregut të Epërm/Gornji Crnobreg.